

ABSTRAKTI

Ndërmjetësimi si procedurë alternative ndihmon në efikasitetin e sistemit të drejtësisë duke zvogëluar ngarkesën e punës së gjykatave, duke përmirësuar cilësinë e përgjigjes ndaj qytetarëve dhe duke i ofruar atyre mundësinë për të zgjidhur një mosmarrëveshje me kosto të ulët. Si rezultat i këtyre përparësive, ndërmjetësimi si procedurë alternative ka gjetur zbatim edhe për zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve në çështjet penale. Prandaj, qëllimi i këtij hulumtimi është ta analizoj ndërmjetësimin në çështjet penale sipas legjislacionit në Kosovë dhe zbatimin e tij në praktikën e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega Drenas gjatë periudhës kohore 2018-2022. Të dhënat janë mbledhur nga analizimi i legjislacionit për ndërmjetësimin dhe nga praktika e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Drenas.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se dispozitat e përfshira në legjislacionin e Kosovës, Kodin nr.08/L-032 të Procedurës Penale, Ligjin për Ndërmjetësim, ofrojnë bazë të mjaftueshme ligjore për zbatimin e ndërmjetësimin në praktikë. Sipas rezultateve të hulumtimit, në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Dega në Drenas gjatë periudhës 2018-2022, ky institut është aplikuar në 201 raste penale, ku kemi vetëm tre marrëveshje të dështuara ndërsa marrëveshjet e arritura janë kryesisht për veprat penale: lëndim i lehtë trupor, vjedhja e shërbimeve dhe kanosja. Përkundër përparësive të kësaj mënyre të zgjidhjes së rasteve të veprave penale, ndërmjetësimi ende nuk zbatohet mjaftueshëm nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Dega në Drenas.

Fjalët kyçe: Palët, ndërmjetësimi, marrëveshja, legjislacioni, gjykata.